

Aktivistët nga Halebi njoftojnë se forcat që luftojnë në anën e presidentit sirian Bashar al-Asad, përfshirë ushtrinë siriane arabe dhe milicinë Liwa al-Quds, kanë pasur një kundërsulm të dështuar ndaj rebelëve nga grupi Jaish al-Fateh në Hundarat, dhjetë kilometra nga Halebi.

Videoja e publikuar nga lëvizja Nouredine al-Zanki, përcjell Telegrafi, shfaq luftimet mes dy palëve në Hundaratu.

Në video shfaqen anëtarët e Liwa al-Kudsit dhe luftëtarë të tjerë pro-qeveritarë të cilët largohen nga zona.

Deri te luftimet Hundaratu ka ardhur vetëm disa orë pas përfundimit të një armëpushimi 48 orësh në haleb, e cila u pasua nga një seri e sulmeve ajrore në pjesë të ndryshme të qytetit.

Dështimi i forcave të regjimit në Hundaratu ka ndodhur pas humbjeve të fundit në luftën me koalicionin Jaish al-Fatihut në periferinë jugperëndimore të Haleb.